



Parku Kombëtar Shebenik - Jabllanicë

Mrekullia e natyrës që të gjithë dëshirojnë ta vizitojnë

Karakteristikat e parkut

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë përfshin disa nga zonat më të bukura malore në lindje të Shqipërisë. Ky territor, i ndodhur në qarkun e Elbasanit, u shpall si Park Kombëtar në vitin 2008, duke mbuluar një sipërfaqe prej 33.928 hektarësh. I shtrirë në lartësi nga 270 deri në 2.260 metra mbi nivelin e detit, ky park karakterizohet nga një shumëllojshmëri kushtesh klimatike, formacionesh gjeologjike, peizazhesh, habitatesh dhe llojesh bimore apo shtazore.

© SHYQYRI PALI



© O.Lama / PPNEA

© PPNEA

© PPNEA

Monumentet e natyrës

Burimi i Studnës / Spring
Shpella e Akullit / Ice Cave
Shpella Eremite Koshorisht / Eremite Cave
Gurra e Koshorishtës / Spring
Liqeni i Shebenikut / Lake
Liqeni i Varrit të Plakës / Lake
Liqenet e Rrajcës / Lake
Mështekna e Qarrishtës / Silver birch
Liqeni i Draganit / Lake
Shpella e Plakës Gizavesh / Cave
Shpella e Kusarit / Cave
Shpella e Rinës / Cave
Shpella e Gurit Venjës / Cave



© O.Lama / PPNEA



© PPNEA / BLRP



© MIRJAN TOPI



© PPNEA / AKZM / BLRP



© XH.XHERRI/PPNEA



© O.LAMA/PPNEA



© PPNEA/BLRP


Biodiversiteti në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë prej vitesh është vendosur në fokusin e studiuesve të jetës së egër. Monitorimi i parë me kamera kurth në këtë zonë është realizuar në vitin 2009, ndërkohë që në vitin 2012 ekipi i PPNEA-s arriti të fotografojë një prej llojeve më të rrezikuar në botë, siç është rrëqebulli i Ballkanit. Që prej asaj kohe, monitorimi i jetës së egër ka vazhduar në mënyrë konstante si prej organizatave mjedisore, ashtu edhe prej Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Elbasan, duke vërtetuar midis të tjerave praninë e 6 llojeve që renditen në Shtojcën II të Konventës së Bernës, si dhe 14 llojeve që renditen në Librin e Kuq të faunës shqiptare.

Në brendësi të parkut gjendet një numër i përgjithshëm prej 84 llojeve shpendësh, nga të cilat 67 % janë renditur në shtojcën II të Konventës së Bernës. Akoma më tej, Shebenik-Jabllanica strehon një numër të konsiderueshëm amfibësh, reptilësh dhe peshqish të ujërave të ëmbla.

Duke u bazuar në praninë e llojeve të bimëve të rrezikuara dhe endemike, Parku Kombëtar Shebenik - Jabllanicë identifikohet si një nga 45 zonat e rëndësishme të bimëve të vendit.


© SVETOSLAV SPASOV





Tradita lokale

Parku Kombëtar Shebenik-Jabllanicë përfshin gjashtë njësi administrative, me një popullsi të përgjithshme prej 44.677 banorësh. Kjo zonë ka qenë vazhdimisht e banuar nga njerëz, ku mund të përmendim praninë e vendbanimeve të hershme që datojnë deri në periudhën e bronzit apo të hekurit. Popullsia lokale në brendësi të parkut më së shumti është e fokusuar te bujqësia dhe blegtoaria, duke prodhuar produkte ushqimore si qumështi, djathi, gjalpi, por edhe një prej varieteteve të patates më të kërkuar në Shqipëri, siç është patatja e Steblevës. Megjithatë, ardhja e turistëve në këtë zonë ka bërë që të ngrihen shumë bujtina, një model i qëndrueshëm biznesi që shkon në krahë të ruajtjes së natyrës.



Na vizito

Qendra e vizitorëve në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë gjendet në fshatin turistik Fushë-Studë. Kohë pas kohe kjo qendër është shndërruar në pikën kryesore të orientimit për turistë vendas e të huaj, të cilët dëshirojnë të shijojnë gjithçka çfarë ofron Shebenik-Jabllanica. Brenda qendrës së vizitorëve, nëpërmjet materialeve të vendosura në dispozicion nga Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan, çdo turist mund të informohet në detaje mbi karakteristikat e parkut dhe jetën e egër që ai mbart.



PA4NP

Kjo fletëpalosje u mundësua nga projekti Zonat e Mbrojtura për Natyrën dhe Njerëzit (PA4NP), i cili është duke u implementuar nga organizata e parë mjedisore në Shqipëri PPNEA, me mbështetjen e WWF Adria dhe Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Sida).

Ky projekt synon:

- Përmirësimin e politikave kombëtare për zonat e mbrojtura dhe ruajtjen e biodiversitetit;
- Nxitjen e llogaridhënies së vendimmarrësve;
- Rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e zonave të mbrojtura;
- Promovimin dhe mbështetjen e aktivizmit civil;
- Rritjen e angazhimit të komuniteteve lokale në menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Për informacion më të detajuar mbi projektin vizitoni faqen: **ppnea.org**.

© XH.XHERRI / PPNEA

Ruajtja e biodiversitetit në Shqipëri dhe sigurimi i mirëqenies për brezat e tanishëm dhe ata që do të vijnë.